

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Goditet banda e shqiptarëve që trafikonin emigrantë, sekuestrohen shuma parash, armë zjarri dhe automjete

21 Qershor, 2020 11:28 |



Madhësia e tekstit:  

 Policia e Shtetit zbulon një rrjet trafikantësh shqiptarë, të cilët në bashkëpunim me shtetas të huaj trafikonin në mënyrë ilegale qytetarë nga Lindja e Mesme drejt vendeve europiane kundrejt parave.

 Gjatë aksionit, policia ka arrestuar 6 shqiptarë, si dhe ka sekuestruar shuma parash, armë zjarri pistoletë, automjete e prova të tjera.

Goditet banda e trafikantëve shqiptarë, sekuestrohen shuma parash, ...



Njoftimi i policisë:

Finalizohet operacioni policor “Stafeta”.

Goditet një grup kriminal që merrej me organizimin dhe drejtimin e trafikimit të emigrantëve të paligjshëm nga Lindja e mesme drejt vendeve të BE-së.

Vihen në pranga 6 shtetas.

Sekuestrohen shuma parash, armë zjarri pistoletë, automjete e prova të tjera.

Në vijim të goditjeve të njëpasnjëshme ndaj veprimtarisë kriminale në fushën e kontrabandimit të emigrantëve nga Lindja e Mesme drejt vendeve të BE-së, Seksioni për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Sektorin e Operacioneve Speciale në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në koordinim nga Departamenti i Policisë Kriminale dhe nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pas një hetimi gati 8-mujor ka finalizuar me sukses operacionin “Stafeta”, duke goditur një aktivitet të paligjshëm në fushën e trafikimit të personave.

Në kuadër të hetimeve të procedimit penal të vitit 2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është bërë e mundur të dokumentohet veprimtaria kriminale dhe ndalimi i shtetasve: A. O., 36 vjeç, M. I., 30 vjeç, A. V., 39 vjeçe, A. B., 20 vjeçe, të katërt banues në Tiranë, si dhe A. P., 21 vjeç dhe M. P., 19 vjeç, të dy banues në Korçë.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe persona të tjerë në Greqi, Turqi dhe Lindjen e Mesme, për një periudhë 9-mujore kanë organizuar dhe drejtuar veprimtarinë kriminale të trafikimit të personave me origjinë nga Lindja e Mesme në Greqi, Shqipëri deri në përcjelljen e tyre drejt kufirit me Malin e Zi, Kosovën, me destinacion final vendet e Bashkimit Europian.

Gjatë ndjekjes së këtij procedimi penal janë dokumentuar rreth 4 raste të trafikimit të personave nga ky grup dhe sipas të dhënave këta persona merrnin nga 100-300 euro për çdo emigrant nga Bilishti në Tiranë dhe nga Tirana në drejtim të Kukësit ose Shkodrës.

Shtetasit A. O., A. V. dhe M. I. janë kapur në flagrancë në afërsi të rrethrotullit të TEG-ut duke transportuar me automjetet 5 emigrantë të paligjshëm nga Maroku.

Gjatë këtij operacioni policor janë mundur të sigurohen prova materiale të përfitimeve të këtyre personave nga kjo veprimtari kriminale, konkretisht: 12.000 euro, 1 milion lekë, një armë zjarri pistoletë me krehër me fishekë, 10 aparate celularë, mandate tërheqjeje shumash monetare nga agjensitë e transfertave të parave, si dhe dy automjete që shërbenin për të transportuar emigrantët.

Materialet procedurale iu përcollën Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe “Armëmbajtja pa leje”.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [emigrante te paligjshem](#) [policia](#) [trafikante](#)

TË NGJASHME



Goditën me grushte të riun e prangosur, pezullohen nga detyra dy efektivë, Policia e Shtetit: Ja si ndodhi ngjarja

22 Qershor, 2020



I moshuari qëllohet me grushte dhe grabitet në mes të Tiranës, aventura e autorit përfundon me kaq

22 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Polici godet me grushte në fytyrë të riun e prangosur, ndërhyn kolegu për... (VIDEO)

22 Qershor, 2020



Shqiptari vret me thikë tunizianin në Romë, u arrestua pasi u kap duke shëtitur në rrugë

22 Qershor, 2020



EMRI/ Shqiptari humb tragjikisht jetën në Itali, po zëvendësonte disa tjegulla në derën e ndërtesës kur...

22 Qershor, 2020



Ndotën ajrin duke djegur mbeturina, procedohen penalisht dy persona te Gjiri i Lalzit

22 Qershor, 2020



EMRI/ U gjet i vdekur brenda mjetit në Fier-Lushnje, policia sqaron ngjarjen: Shoferi pëson infarkt në timon


22 Qershor, 2020



Drejtuesi humb kontrollin e mjetit në Fier-Lushnje, gjendjet i vdekur në makinë. Policia dyshon se...


22 Qershor, 2020

KATEGORIA VIDEO



Deputeti i dytë shqiptar nga lista "Lugina e Bashkuar": E papranueshme një marrëveshje Kosovë- Serbi që na ndan

22 Qershor, 2020



Videoja e dhunës së policit ndaj një të ndaluarit, Ina Zhupa: Me këtë sjellje Europa na heq vizën e kënqe

22 Qershor, 2020



Debat në 'Real Story', Lubonja: O Baton s'po të kuptoj, vetëm ti je te ndryshimi i kufijve se as Thaçi s'guxon ta thotë!

22 Qershor, 2020



Arben Çejku: Vuçiç shkon në Moskë para Uashingtonit, merr "ok" për marrëveshjen me Kosovën!

22 Qershor, 2020



Marrëveshja Kosovë- Serbi/ Lubonja: Vuçiç do kërkojë të marrë diçka, ja pse BE është kundër shkëmbimit të territoreve

22 Qershor, 2020



Diplomati rendit arsytet që i dhanë fitoren Vuçiç: Ndryshimet që pësoi Serbia gjatë qeverisjes së tij

22 Qershor, 2020